



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2021
PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA
MINISTRIA E MBROJTJES

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021, Ministria e Mbrojtjes nuk ka kryer procesin e konsultimit publik për asnjë nga aktet e miratuara duke qenë se këto akte nuk plotësonin kushtet për t'iu nënshtuar këtij procesi sipas ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

2. Analiza e konsultimeve të kryera në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021

▪ *Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike*

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2021, Ministria e Mbrojtjes ka miratuar gjithsej 13 akte (prej të cilave, 12 vendime të Këshillit të Ministrave dhe 1 ligj), të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk ndodheshin në kushtet për t'iu nënshtuar konsultimit publik duke qenë se nuk janë akte për të cilat kërkohet detyrimisht konsultimi publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik dhe asnjë nga aktet e miratuara nga Ministria e Mbrojtjes nuk hyn në kategoritë e përmendura më sipër.

▪ *Lista e akteve të miratuara në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 dhe arsyet e përjashtimit nga procesi i konsultimit publik*

Aktet e mëposhtme nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, bazuar në kufizimin e përcaktuar në shkronjën “b”, neni 4 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pasi **janë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe dhe lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare.**

1. **Ligji nr. 29/2021** “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të organizatës së traktatit të atlantikut të veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “DEFENDER EUROPE 21”.

2. **VKM nr. 191, datë 31.3.2021** “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s në Irak (NMI)”;

3. **VKM nr. 288, datë 19.5.2021** “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për trajnimin dhe bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë ushtarake”;
4. **VKM nr. 366, datë 22.06.2021** “Për miratimin në parim të “Notës së Aderimit /Deklarimit të Synimit, për t’u bërë pjesë në Memorandumin e Mirëkuptimit (MoU) ndërmjet Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin, si dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë në lidhje me Dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës për Ekzekutimin e Operacioneve/Stërvitjeve/Aktiviteteve të Ngjashme Ushtarake të NATO-s”.
5. **VKM nr. 367, datë 22.06.2021** “Për miratimin në parim të “Notës së Aderimit/Deklarimit të Synimit, për t’u bërë pjesë në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe Shtabit Suprem të Fuqive Aleate në Evropë dhe Shtabit të Komandës Supreme Aleate për Transformimin në Lidhje me Dhënien e Mbështetjes së Shtetit Pritës për Ekzekutimin e Operacioneve/Stërvitjeve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior”.
6. **VKM nr.391, datë 30.6.2021** “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes mbi bashkëpunimin për mbrojtjen ndaj katastrofave në Ballkanin Perëndimor.

Aktet e mëposhtme nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, bazuar në kufizimin e përcaktuar në shkronjën “c” të nenit 4 të ligjit nr.146/2014, pasi janë **akte me karakter individual**.

1. **VKM nr. 91, datë 17.2.2021** “Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Mirditë, të një pjese të pronë nr. 988, me emërtim “Ish-reparti Ushtarak nr. 5014”, me vendndodhje në Rrëshen, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar;
2. **VKM nr. 178, datë 25.3.2021** “Për kompensimin e veçantë të familjes së ushtarakut, i cili humbi jetën gjatë kryerjes së detyrës në mision ushtarak jashtë vendit”;
3. **VKM nr. 190, datë 31.3.2021** “Për miratimin e stemës dhe flamurit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”;
4. **VKM nr. 363, datë 16.6.2021** “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës nr. 442, me emërtim “Ish-Batalion i Gatshëm”, me vendndodhje në Meteor, Shtiqen, Kukës, dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje, truall funksional, pjesë e pronës nr. 436, me emërtim “Ndërtesë Sinoptike”, me vendndodhje në Kukës, kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë te Ministria e Mbrojtjes, të një sipërfaqeje prej 1 181 m2, dy ambiente zyrash te godina e mbrojtjes ndaj zjarrit, dhe për

disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 18.7.2003 dhe nr. 343, datë 7.6.2006”;

5. **VKM nr. 392, datë 30.6.2021** “Për përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Aktet e mëposhtme nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, bazuar në kufizimin e përcaktuar në shkronjën “d” të nenit 4 të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pasi lidhen me **emergjencën civile**.

1. **VKM nr. 158, datë 17.3.2021** “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”;
2. **VKM nr. 319, datë 2.6.2021** “Për caktimin e aeroportit ndërkombëtar të tiranës “Nënë Tereza”, si aeroport rezervë i Forcave të Armatosura, gjatë gjendjeve për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme”.

Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar dhe janë në ndjekje procedurat e konsultimit publik për 4 projektligje, të cilat për shkak së janë ende në proces konsultimi, si dhe përgatitje dhe dërgimi për mendim nuk janë të përfshirë në raportin gjashtë mujor.